



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

PËRSHKRIM PUNE

ANKETA E PËRDORIMIT TË KOHËS

Pozicioni: Anketues terreni

Afati aplikimit: 20.06.2026

Rrethi: Në të gjitha rrethet

Periudha e kontraktimit: 1 vit

Trajnimi zgjat 5 ditë dhe është i detyrueshem. Gjatë trajnimit do të realizohet një proces i vazhdueshëm vlerësimi, dhe në përfundim, kandidatët e suksesshëm do të përzgjidhen për fazën e punës në terren. Trajnimi.

Anketa zhvillohet pranë individëve dhe njësive ekonomike familjare.

Dokumentacioni i nevojshem:

- Kërkesë, ku të specifikohet pozicioni i kërkuar;
- CV ;
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID);
- Kopje e diplomës (arsimi i lartë ose i mesëm).

Detyrat kryesore të anketuesit:

1. Të respektojë dhe zbatojë rigorozisht parimet e statistikave zyrtare.
2. Të njohë shumë mirë përmbajtjen e pyetësorit, koncepteve dhe terminologjisë së përdorur në anketë.
3. Të përgatisë dhe planifikojë intervistat sipas një plani të studiuar dhe dakordësuar me kontrollorët që menaxhojnë procesin e mbledhjes së të dhënave në terren.
4. Të plotësojë pyetësorin në tabletin e marrë në dorëzim dhe pyetësorët e formatit letër, në përputhje me kushtet dhe rregullat teknike të përgatitura nga INSTAT.
5. Të kryejë dhe të drejtojë personalisht intervistat me njësisë statistikore të caktuar për intervistim.
6. Të njohë dhe të respektojë formatet e kontrollit dhe përdorimin e tyre, raportimin ditor tek kontrollorët dhe specialistët e zyrës statistikore me qëllim vlerësimin e progresit të anketës për çdo pyetësor të nominuar.
7. Të raportojë dhe të dërgojë të dhënat në INSTAT sipas një kalendari të miratuar paraprakisht nga personi përgjegjës i anketës.
8. Të shqyrtojë dhe ndjekë bashkë me kontrollorët rastet e refuzimeve eventuale ose mungesës së përgjigjeve për shkaqe subjektive etj.
9. Të kontaktojë specialistin përgjegjës për kryerjen e anketës në INSTAT, për sqarime rreth paqartësive që mund të ketë në lidhje me punën.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

10. Të informojë njësitë statistikore që janë pjesë e vrojtimit për qëllimin e anketës dhe të shpjegojë që të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe studimore, si dhe të nënvizojë faktin që anketa është konfidenciale.
11. Gjatë punës në terren të respektojë dhe zbatojë rregullat e etikës dhe pavarësinë profesionale.
12. Respekton etikën profesionale dhe kodin e sjelljes në marrëdhëniet me kolegët dhe me të intervistuarit.

Kualifikimet:

- Të kenë përfunduar minimalisht arsimin e mesëm;
- Preferohet të jenë studentë në nivelin bachelor ose të kenë përfunduar së paku ciklin e parë të studimeve universitare;
- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë së informacionit, në veçanti përdorimin e pajisjeve si laptopë dhe/ose tabletë;
- Preferohet të kenë përvojë të mëparshme në realizimin e anketave apo intervistimeve të ngjashme në terren.

Aftësi të kërkuara:

- Komunikim dhe bashkëpunim efektiv në grup;
- Gatishmëri për të punuar në grup dhe për të ndjekur udhëzimet e kontrollorëve;
- Preferohet të kenë aftësi për orientim në terren dhe përdorim të hartave për identifikimin e vendbanimeve;
- Të jenë të gatshëm për të përballuar kushtet atmosferike duke pasur parasysh që puna kryhet në terren dhe mund të kërkojë ecje të gjata.

Mënyra e aplikimit: *nëpërmjet postës zyrtare, pranë Institutit të Statistikave (INSTAT) ose nëpërmjet email-it në adresën: rekrutime@instat.gov.al*

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al